

RAPORT TEKNIK

“SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS “KATUND NUAJ” (FAZA II), NJ.
ADMINISTRATIVE CUDHI, KRUGË”

PROJEKTUES: “ERALD-G” SH.P.K

POZICIONI ORTHOFOTO



TIRANË 2024

HYRJE

1.1-Të përgjithshme

Kruja ndodhet rreth 30 km në veri të qytetit të Tiranës. Shtrihet rreth kuotës 600m mbi nivelin e detit, është krejtësisht zonë kodrinore e malore, me pjerrësi të terrenit 10-35% me drejtim lindje-perendim. Në afërsi të saj ka disa kodra të vogla me lartësi 80-120m mbi nivelin e detit. Rritja e ritmeve të zhvillimit në vendin tonë, dhe atij turistik në veçanti, kërkojnë investime të vazhdueshme si për përmirësimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe të ndërtimit të rrugëve të reja për t'iu përgjigjur trafikut gjithmonë në rritje.

Shoqëria projektuese (konsulente) “Erald-G” shpk në bazë të termave të referencës (detyrës së projektimit), ka kryer studim-projektimin e kësaj rruge, ka kaluar të gjitha fazat sipas programit të hartuar, duke filluar nga:

- Projekt idea
- Takime në Bashkinë Krujë

Projekti përmban:

1. Studimin e Projekt Idesë.
2. Studimin e Ambjentit.
3. Relacionin teknik që përmban një përshkrim të përgjithshëm për zonën, të dhëna mbi gjendjen ekzistuese të territorit të rrugës e rajonit përreth, përshkrimin mbi hartimin e projektit, llogaritjet e infrastrukturës, llogaritjet konstruktive, etj.
4. Specifikimet teknike.
5. Vizatimet e punës si: planimetrinë e përgjithëshme të rikonstruksionit të rrugës, planimetritë e disiplinimit të ujrave, projektin mureve mbajtëse, vizatimet konstruktive, të gjitha detajet dhe hollësitë, etj.
6. Preventivin paraprak për rikonstruksionin e objektit.

Si shoqëri konsulente për hartimin e projektit jemi bazuar tek standartet dhe kushtet teknike shqiptare (keto kushte teknike shtrihen në studimin dhe projektimin e rrugëve).

1.2-Kushtet klimaterike

Në nënzonën mesdhetare jugore ndryshimi ditor i temperaturës shkon nga një minimum rreth agimit, në një maksimum nga 1 deri 3 orë mbasi dielli ka aritur në zenith, mbas të cilës ka një rënje të vazhdueshme gjatë natës deri në agim.

Temperatura mesatare ditore është mesatarja e temperaturës maksimale dhe minimale dhe normalisht është brenda kufirit të mesatares të vertetë që regjistrohet në mënyrë të vazhdueshme

Temperatura është matur në gradë Celsius (°C). Nga vrojtimet e deritanishme rezulton se maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është 39.5 gradë. Në Shqipëri në shtresën e ajrit që është 2m larg sipërfaqes së tokës konstatohet një amplitudë e lartë termike prej 68.2 grade, kjo është një vlefë e ndjeshme por gjithnjë karakterizuese për vendet mesdhetare, me një relief të

thyer siç është Kruja. Temperatura mesatare vjetore ne Kruje eshte 15.3°C. Temperatura mesatare e janarit 5.8°C, e korrikut 26.6°C, temperatura absolute me e ulet ne Kruje eshte -13°C, me e larta absolute 38.1°C. Reshjet mesatare vjetore 1618 mm për Kruje. Kjo zone karakterizohet nga diferenca te medha intesitetesh reshjesh.

Hidrologjia e krahinës së Krujës (ku përfshihet edhe fshati Nuojë i Nj.A.Cudhi), varet së pari nga klima, së dyti nga topografia dhe gjeologjia. Faktorët klimatikë të një rëndësie parësore janë rreshjet dhe mënyra e perhapjes së tyre, lagështia, temperatura dhe era, te cilat ndikojnë në avullimin dhe transpirimin.

Faktoret klimatikë të cilët janë marë në konsideratë në analizë përfshijnë:

- Temperatura e ajrit,
- reshjet dhe analiza e tyre,
- bora dhe
- era.

Të dhënat që mbështesin këtë analizë janë marë nga vendmatjet të zgjedhur dhe janë përmbledhur në tabelën 2.1 .

Regjistrimet klimatike nga stacionet klimatologjike mund të konsiderohen përfaqësuese të kushteve të pritura në zonën pas Malit Krujë, në fshatin Nuojë, Cudhi. Statistika klimatike të publikuara për periudhën nga 1942 janë përmbledhur në tabelë.

1.3. Popullsia

Të gjitha të dhënat mbi popullsinë e fshatit Nuojë dhe Nj.A.Cudhi u dhanë nga Bashkia Krujë dhe në detyrën e projektimit. Popullsia e Njësisë Administrative Cudhi deri ne vitin 2012 nga të dhënat e Bashkisë është 2600 banorë. Studiusit demografë japin të dhëna të përafërta me ato të Bashkisë.

1.4. Ekonomia

Kruja (përfshirë edhe Cudhinin) renditet ne qendrat me nje zhvillim te mire ekonomik, historik, tregtare te vendit. Jo vetem Kruja, por i gjithe rrethi ne teresi ka luajtur historikisht nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin ekonomik te krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per t'u zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithate midis tyre vlen te veçohen sektore te tille si turizmi, industria e cimentos, e mobilerise, me pak ekonomia bujqesore.

1.5. Rilevimi Topografik dhe Hartat Bazë.

Rilevimi topografik i nevojshem eshte kryer instrument GNSS (GPS). Matjet topografike janë realizuar me metodën e RTK kinematike në kohë reale e cila përdor dy marrësa ku baza vendoset në një pikë me koordinata të njohura merr sinjalin e përpunon dhe pastaj e transmeton me radio Roveri është i pajisur me një antenë radio, bën llogaritjen e koordinatave dhe bëhet korigjimi Në rastin tone baza është stacioni i AlbCors më i afërt, me anë të përdoruesit të krijuar nga ASIG jam lidhur me stacionin bazë duke shfrytëzuar rrjetin Wireless të aparatit celular për të filluar matjet minimalisht duhet pesë 5 satelitë dhe saktësia që ofron metoda RTK është 8 mm në Horizontalitet dhe 15 mm në Vertikalitet Sistemi koordinativ i përdorur është KRGjSh. Në vijim krijuam një folder të ri për punën tonë realizuam lidhjen me sistemin AlbCors dhe kryem matjet duke marre pikat sipas një rregulli me skajet e objekteve fillimisht në njërin kah dhe pastaj në kahun tjetër duke marrë të dhënat topografike për elementët kryesorë të terreni dhe elementët e tjerë të relievit. Çdo pikë e shoqëruam me kodin përkatës duke përdorur tastirën.

Pikat topografike do të vendosen gjatë procesit të piktimit. Ato janë kulla celiku me bazament ose shenjime në ndertime të përhershme. Nivelet e pikave topografike do të bazohen në të dhënat e rrjetit KRGjSh; afërsisht gjatë do të vendosen në çdo kilometër katror në zonat e banuara dhe çdo 300-500m përgjatë rrugëve të hyrjeve.

Të gjitha hartat janë në formate elektronike bashkë me një palë kopje të riprodhueshme.° Janë përcaktuar ndertimet e përhershme dhe të përkohshme, shkarkimi I ujërave të zeza , muret rrethuese, gardhet portat e hyrjeve, kufijte e parcelave. Janë treguar objektet në ndertim.

° Në planimetri janë dhënë tubat kryesore, pusetat e ujërave të zeza dhe pusetat e kontrollit të shtrira në sipërfaqen e tokës, si dhe përroi në anën lindore.

° Janë dhënë dhe përcaktuar linjat e Energjisë Elektrike, linjat e tensionit, shtyllat, transformatorët, lidhjet me banesat, ndricimi rrugor.

° Në punimet topografike janë hedhur rruget dhe kalimet, dallohen rruget e shtruara dhe gjurmët e tyre.

° Mbeturinat e ngurta janë trajtuar dhe do të transportohen në vendet e hedhjeve të mbeturinave.

Rrjeti telefonik do të tregohet dhe të përcaktohen linjat , kabinat telefonike etj.

Hartat e përdorura për hartimin e këtij projekti , janë në shk.1:200, ndërsa vizatimet në shkallën 1:50. Projekt-zbatimi është punuar mbi hartat e shkallës 1:500 të marra nga Zyra e DPKZHT.

B. FOTO TË GJËNDJES EKZISTUESE






Figura 2, Foto të objektit në gjëndjen ekzistuese

C.SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E RRUGES.

Kjo rrugë fillon në Kryqëzimin e rrugës nacionale Krujë-Qafë Shtamë, në fshatin Nuojë të Njësisë Administrative Cudhi, Krujë, kalon poshtë Malit të Krujës (në krahun lindor), drejtë veri-lindjes, përshkon një gjatësi prej 1670m e përfundon tek përroi. Kjo fazë parashikon sistemim-asfaltimin e Segmentit të dytë të rrugës, i cili fillon në Kryqëzimin e rrugës Nuojë me rrugën e Nojës së Vjetër, në fundin e zonës së banuar (Pk.0), përshkruan një gjatësi prej 796m në drejtimin e veri-lindjes dhe përfundon tek përroi (fundi i rrugës). Meqenëse është një rrugë që ka terren të vështirë është menduar që të realizohet me faza, pasi ka shumë vepra arti. Po ashtu edhe gjërësia e pjesës asfaltike do të jetë 2.75m dhe e pjesës kaluese 3.25m, me një sens lëvizjeje me “xhepa” për ndërrimin e mjeteve, pasi zgjerimi i saj kërkon një buxhet shumë të madh, si edhe referuar numrit të vogël të mjeteve. Është një rrugë mjaft e rëndësishme, pasi lidh një numër të konsiderueshëm banesash të cilët e kanë të pamundur aktualisht komunikimin me mjete për kryerjen e shërbimeve pasi rruga është thuajse e pakalueshme. Rruga përgjithësisht është në gjendje të demtuar, demtime të cilat arrijnë deri në nenshtresa, dhe është pjesërisht e paasfaltuar, dhe është llogaritur që të asfaltohet totalisht.

Parametrat e rrugës janë:

- Gjatësia e rrugës 796m.
- Numri i gjurmeve të kalimit, 1.
- Gjerësia e shtresës asfaltike 2.75m
- Gjerësia e shtresës stabilizant e çakëll 3.25m.
- Gjerësia totale e rrugës 3.25-4.0m.
- Gjerësia e bankinave 2x0.25m.
- Mure mbajtëse b/a. (6 mure).
- Shpejtësia e llogaritur e levizjes së mjeteve deri 10-20 km/h.

**PER GRUPIN E PROJEKTIMIT
“ERALD-G” SHPK
ADMINISTRATORI
ING.GËZIM ISLAMI**